



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

E-mail: info@cec.org.al Web: www.cec.org.al



NËNKOMISIONER

KOMISIONER

RELACION

për projektvendimin

“Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë në nenin 22, parashikon kompetencat e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje ndërsa në nenin 179, pika 1, përcakton se sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit që do të përdoren në zgjedhjet do të impelmentohen me projekte pilot, të cilat duhet të përfshijnë jo më shumë se 20 për qind të zgjedhësve.

Për marrjen e masave për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e mësipërme, është ngritur grupi i punës “Për Vlersimin e Sistemeveve apo Paisjeve të Teknologjisë së Informacionit”.

Grupi i Punës, në përmbushje të detyrave të përcaktuar hartoi raportin “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që do të përdoren në zgjedhje”

Raporti i grupit të punës paraqet :

1. Implementimin e Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Votimit dhe Rezultateve (SEMVR) për votimin dhe numërimin elektronik si dhe përdorimin e Pajisjeve Elektronike të Votimit dhe Numërimit (PEVN).
2. Sistemi Elektronik i Menaxhimit dhe Rezultateve duhet të operojë në pajisje dhe një rrjet të dedikuar në mjediset e KQZ-së, te paaksesueshëm dhe duhet të mundësojë konfigurimin e plotë të pajisjeve PEVN dhe të mundësojë qendërzimin e te dhënave në mënyrë të sigurtë nga pajisjet Elektronike të Votimit.
3. Implementimi i SEMVR duhet të sigurojë që:
 - a. Qendra e Votimit duhet të jetë e pajisur me pajisje PEVN, ku zgjedhja e subjektit zgjedhor nga votuesi bëhet në ekranin e PEVN-së.
 - b. Procesi i identifikimit dhe procesi i votimit dhe numërimit elektronik janë tërësisht të ndarë prej njëri tjetrit për të pamundësuar lidhjen e votuesit me votën. Gjithashtu nuk duhet të ketë komunikim apo shkëmbim të dhënash midis pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI) dhe pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN).
 - c. Sistemi duhet të garantojë plotësisht integritetin e të dhënave që ruhen në pajisje. Çdo votë në

PEVN duhet të ruhet pa referenca kohore dhe duhet të garantohet me standardet më të larta të fshehtësisë, çdo votë duhet të ruhet në dy memorie fizike të veçanta pjesë të pajisjes dhe do të ketë kopjen e saj në një dokument të printuar në letër. PEVN garanton votuesit konfirmimin e votës nëpërmjet shfaqjes së saj në ekran. PEVN mundëson printimin automatik të dokumentit në kutinë e montuar në pajisje.

- d. Ekрани me prekje i PEVN duhet të ketë përmasa të mjaftueshme për t'u përdorur lehtësisht nga votuesi në një fletë A4.
 - e. PEVN duhet të jetë një pajisje plotësisht e integruar, pa komponentë të jashtëm e cila mund transportohet dhe të vendoset në punë lehtësisht.
 - f. Pajisjet do të veprojnë në mënyrë autonome dhe pa u lidhur në rrjetet e komunikimeve elektronike.
 - g. PEVN duhet të ketë bateri për të operuar përgjatë gjithë procesit të votimit dhe numërimit të pavarur nga energjia elektrike dhe si ndaj çdo komponenti të brendshëm dhe ose port komunikimi duhet të jetë fizikisht i mbyllur dhe i siguruar me vula sigurie. Kutia që ka dokumentin e printuar sipas parashikimit të germës “d” të pikës 9 të këtij vendimi duhet të sigurojë integritetin fizik të tyre nga ndërhyrje të paautorizuara.
4. Me qëllim implementimin dhe përdorimin e sistemit elektronit të votimit dhe numërimit, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, duke marrë në konsideratë kohën e shkurtër në dispozicion të KQZ-së si dhe referuar parashikimit ligjor të nenit 179, pika 1 dhe 3 të Kodit Zgjedhor, Autoriteti Kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit të parashikuar në nenin 33, pika 2, germa “c” të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.
 5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Komisioneri dhe Nënkomisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve, të cilët i paraqesin kërkesën Këshillit të Ministrave për alokimin e fondeve në zbatim të nenit 179, pikës 2 të Kodit Zgjedhor.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

NËNKOMISIONERI
Lealba PELINKU

KOMISIONERI
Ilirjan CELIBASHI